

**STATUTI I  
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“Infinity SH.P.K”**

Sot më datë 10/03/2022 si themelues me te dhenat e meposhtme:

Znj. Enida Rusi e lindur ne Tirane me date 27/04/1982 mbajtes e leternjoftimit.ID:  
I25427061k dhe banuese ne Tirane

Kompania APT Cable shpk me NIPT L84623801J , adrese Vlore Sarande,z Lagjja  
nr.2, rruga Abedin Dino, pallati nr.8, kati i pare dhe administratore Znj.Kostandina  
Thanasi lindur ne Gjirokaster me date 02/11/1959 mbajtes e leternjoftimit.ID:  
F96102117U.

kane vendosur të nënshkruajne Statutin e mëposhtëm të një shoqërie me  
përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga Legjislacioni shqiptar në  
fuqi dhe nga ky Statut.

**KREU I  
FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**Neni 1 - Forma**

- 1.1 Shoqëria “Infinity SHPK” ( në vijim “Shoqëria”), krijohet në formën e një  
shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të  
këtij Statuti dhe Aktit të Themelimit.
- 1.2 Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3 Akti i themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionit shqiptar që ka  
karakter të detyrueshëm, ndërsa cështjet që nuk janë shprehimisht të  
parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqipëtar.

**Neni 2 - Emërtimi**

Emërtimi i Shoqërisë është “Infinity SHPK”

**Neni 3 - Objekti i shoqërisë**

- 3.1 Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me  
legjislacionin Shqipëtar në fuqi.
- 3.2 Kryerja e shërbimeve të internetit me ADSL, Fiber Optike (Dark Fiber, FTTH,  
Epon/Gepon, Active Ethernet). Ofrimin e shërbimit IPTV, OTT (HLS, VoD,  
CatchupTV). Ofrimin e shërbimit Transmetim të Dhenash (LAN to LAN, MPLS,  
VLAN), email, webhosting të abonenteve të ndryshëm, videokonferencat etj.  
Kryerjen e shërbimeve telefonike fikse (analog, VoIP, SIP) dhe shërbime të  
tjera kryesore dhe aksesore të lidhura me telefonine fikse. Kryerjen e aktivitetit  
të transmetimeve audio dhe audiovizive nepermjet sistemit online ose



sistemeve te tjera te telekomunikacionit per transmetimet dhe ritransmetimet audio dhe 2 audiovizive te cdo lloji, si dhe shitjen e produkteve apo sherbimeve audio dhe video ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise dhe rregulloret perkatese te miratuara nga autoritetet rregullatore kompetente

#### **Neni 4 - Selia**

- 4.1 Selia e shoqërisë është Blloku Nr.1, Rruga: Bonifikimi, Maliq, Korce  
4.2 Transferimi i Selisë së shoqërisë në një vend tjetër do të bëhet nga Vendimi i Asamblesë së Ortakëve.  
4.3 Asambleja e Ortakëve do të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe zyrave përfaqësuese në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë vendit.

#### **Neni 5 - Kohëzgjatja**

- 5.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e papërcaktuar.

### **KREU II KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE**

#### **Neni 6 - Kapitali themeltar**

- 6.1 Kapitali Themeltar është 100 (njëqind) Lek.  
6.2 Kapitali Themeltar i shoqërisë është i ndare në 2 (dy) kuota.  
6.3 Ortaket e shoqërisë dhe kuotat perkatese te tyre jane si me poshte:  
Znj. Enida Rusi do te zoteroje 1 (nje) kuote te barabarte me 51% (pesedhete e nje) perqind te kapitalit te shoqerise.  
APT Cable me perfaqesues Znj.Kostandina Thanasi do te zoteroje 1 (nje) kuote te barabarte me 49% (dyzete e nente) perqind te kapitalit te shoqersie

#### **Neni 7 - Kontributet**

- 7.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:

- Znj. Enida Rusi , ofron një kontribut në para të barabartë me 51(pesedhete e nje) lekë.
- APT Cable me perfaqesues Znj.Kostandina Thanasi, ofron një kontribut në para të barabartë me 49(dyzete e nente) lekë.

#### **Neni 8 – Rritja e kapitalit themeltar**





- 8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në cdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- 8.2 Në rast rritjeje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me pjesët e kapitalit të zotëruara. Në rast se disa nga ortakët nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

### **Neni 9 - Zvogëlimi i kapitalit themeltar**

- 9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Ortakëve. Në cdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 9.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

### **Neni 10 - Transferimi i kuotave**

- 10.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 10.2 Në rast transferimi në cdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim në kuptimin më të gjerë të fjalës, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjerë të ndryshem nga ortakët, kuotat duhet më parë t'i ofrohen në parablerje ortakëve të tjerë.
- 10.3 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë kuotën e tij duhet të njoftoj ortakët e tjerë, me leter rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar cmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet t'i referohet të gjitha kuotave të ofruar për shitje.
- 10.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kane hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuotat e afuara nga ortaku që transferon kuotat, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me kuotat që ata zotërojnë, përvec rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.
- 10.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht.
- 10.7 Kuotat mund të transferohen për shkak trashëgimie *mortis causa*.

## **KREU III ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL**





## **Neni 11- Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj**

- 11.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.
- 11.2 Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese: ndryshimet e statutit, emërimi e shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël e likuidatorëve, zmadhimi, dhe zvogëlimi i kapitalit, transferimi i kuotave, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, miratimi i bilancit dhe për çdo vendim tjetër parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni përkatës.

## **Neni 12 - E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës**

- 12.1 Cdo ortak ka ta drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i kuotave që ai zotëron.
- 12.2 Cdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.
- 12.3 Ortaku nuk mund të lëshojë prokura për votim për një pjesë të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.

## **Neni 13 - Thirrja e Asamblesë së Ortakëve, Kuorumi dhe Vendimet**

- 13.1 Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël si dhe inventarit.
- 13.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve si dhe prej një ose disa ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje me fax apo telegram që duhet t'u dërgohet ortakëve në adresën që rezulton në Librin e Ortakëve - dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 8 (tetë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat dotë merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.
- 13.3 Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë, vec në Itali ose në Shqipëri.
- 13.4 Në rast se Asambleja e Ortakëve nuk mbledhet me thirjen e parë për mungesën e kuoromit të parashikuar në pikën 13.7 të këtij Statuti, Asambleja e Ortakëve do të thirret brenda 30 (tridhjetë) ditësh me të njëjtin rend dite.
- 13.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të çështjeve në rend të ditës; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja



- konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.
- 13.6 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar.
- 13.7 Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 70% (shtatëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblesë së Ortakëve që kërkojnë një shumicë të cilësuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 70% (shtatëdhjetëpërqind) të kapitalit themeltar.
- 13.8 Asambleja e Ortakëve vendos me shumicë të cilësuar ndryshimet e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, me votën pro të  $\frac{3}{4}$  (tre të katërtat) e ortakëve të pranishëm. Nëtë gjitha rastet e tjera, Asambleja e Ortakëve merr vendime me shumicë të thjeshtë votash të ortakëve të pranishëm.
- 13.9 Cdo Asamble drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga vetë Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.
- 13.10 Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga Sekretari.

#### **Neni 14 – Administrimi**

- 14.1.1 Shoqëria administrohet nga një administrator i cili do të qëndrojë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh.
- 14.1.2 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorit.  
Administratori mund të ushtrojë të gjitha fuqitë konform me sa parashikohet në nenin 95 të Ligjit n. 9901 të datës 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 14.1.3 Administratori mund të emërojë përfaqësues të posacëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.
- 14.1.4 Administrator i pare i shoqërisë emerohet **Znj. Irimi Kaçe**, lindur ne Elbasan ne date 13/06/1977 mbajtes i leternjoftimit ID H75613080C

#### **Neni 15- Eksperti kontabël i autorizuar**

- 15.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar.
- 15.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.





**KRE IV**  
**VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

**Neni 16 - Viti financiar dhe bilanci vjetor**

- 16.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- 16.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.
- 16.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicën e kërkuar nga Ligji n. 9901 të datës 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 16.4 Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

**Neni 17 – Fitimet**

- 17.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara.
- 17.2 Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të vecanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

**KREU V**  
**SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISË**

**Neni 18– Prishja**

- 18.1 Shoqëria priset me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.
- 18.2 Shoqëria nuk priset në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.

**Neni 19 – Likuidimi**

- 19.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likujdohet.
- 19.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit, dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 19.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.



19.4 Pas pagimit të kreditoreve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

## **Neni 20 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

20.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti dhe aktit të themelimit, si edhe atë që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përvec atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejte ndërmjet palëve të interesuara.


20.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, palët mund të bien dakord për zgjidhjen e mosmarrëveshjes nga një kolegji arbitral i përbërë prej tre arbitra.

## **Neni 21 –Gjuha**

21.1 Ky Statut është hartuar në 4 (kater) kopje në gjuhën shqipe.

## **ORTAKET**

**Enida Rusi**



**APT Cable**

**Kostandina Thanasi**

